

**PROCESVERBAL**  
**nga seanca e njëzet e katërt e Këshillit të Agjencisë për Shërbime**  
**Mediatike Audio dhe Audiovizuale,**  
**mbajtur më 21.7.2023**

**Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë nëpërmjet lidhjes video-konferencë:** Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

**Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /**

**Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, drejtori Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.**

**Të pranishëm nga Shërbimi Profesional nëpërmjet lidhjes video-konferencë:** Vesna Simonovska, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, Maja Damevska, mr. Ruzhica Boshnakoska Jotevska, dr. Ivana Stojanovska.

**Të panishmit e tjerë: /**

Z. Petrushevski hapi seancën e njëzet e katërt të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 12:00 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 6 vota „pro“ miratoi si vijon:

**RENDIN E DITËS**

1. Miratim i Propozim-procesverbalit nga seanca e 23-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 19.7.2023.
2. Propozim për iniciimin e procedurës për heqje të lejes për transmetim në televizion të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive IRIS SHPK Shtip.
3. Të ndryshme.

**Pika 1**

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe me 5 vota „pro“ dhe një abstenim nga z. Mashoviq, miratoi Procesverbalin e propozuar të seancës së 23-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, të mbajtur më 19.7.2023, me tekstin e propozuar.

## Pika 2

Z. Trajçevski shpjegoi Propozimin për iniciimin e procedurës për heqje të lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive televizioni IRIS SHPK Shtip. Ai shpjegoi se transmetuesi në fjalë ka dorëzuar njoftim në Agjenci, ku thuhet se për një kohë të gjatë nuk ka transmetuar program, se është hapur procedurë falimentimi dhe në të njëjtën kohë kërkon të kthejë lejen për transmetim televiziv. Ai ka shpjeguar se njoftimi nuk ishte i noterizuar dhe për këtë arsye Agjencia ka kërkuar nga transmetuesi, personat që duhet të paraqesin deklaratë, përfshirë edhe administruesin e falimentimit, që të dorëzojë deklaratë të noterizuar. Ai ka shpjeguar se në anën tjetër janë plotësuar kushtet për iniciimin e procedurës për shkak se televizioni për më shumë se 30 ditë nuk ka transmetuar program, dhe sipas vërejtjes zyrtare nga Sektori i mbështetjes informatike dhe i punëve të përgjithëshme nuk ka transmetuar program për më shumë se 90 ditë. Ai informoi se sot skadon afati shtesë për dokumentacionin që duhet të dorëzojnë në Sektorin për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit, përkatësisht për dorëzimin e të dhënave në pajtim me nenin 15 paragrafi (1) të Ligjit për media. Duke qenë se nuk kanë dorëzuar dokumentacionin brenda afatit, ekziston dhe një kusht tjetër për të cilin mund të nisë procedura për heqjen e lejes. Gjatë marrjes së vendimit përfundimtar, do të evindentohet dhe mosplotësimi i dispozitave të Ligjit për Media për mos dhënie të informacionit lidhur me punën e tyre nga viti paraprak.

Z. Petrushevski tha se Këshilli ka disa vite që përcjell punën e TV Iris dhe mund të konstatohet se në vitet e fundit transmetuesi ka pasur probleme financiare me pagesën (kompensim) e tarifës vjetore për leje. Tani ndoshta ka ardhur momenti që nuk mund të qëndrojë financiarisht, dhe nga materialet e dorëzuara shihet se edhe themeluesi ka probleme financiare. Sipas kësaj, Këshillit nuk i mbetet gjë tjetër veçse të inicojë procedurë. Nga ana tjetër, dhe vetë transmetuesi ka intencë ta kthejë lejen, por për arsye teknike nuk ka arritur t'i dorëzojë të gjitha dokumentet.

Këshilli i Agjencisë njëzëri inicoi procedurën për heqje të lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive televizioni IRIS SHPK Shtip, nr.08-902 datë 8.7.2015, për shkelje të nenit 82 paragrafi (1) nënparagrafi 2 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19) dhe (Gazeta Zyrtare e RMV-së“ nr.42/20 dhe 77/21).

Në pajtim me Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrativë, të jashtëzakonshëm sipas detyrës zyrtare, nr.03-2910/1 datë 20.7.2023 poseduesi i lejes ka ndërprerë me transmetim të shërbimit programor për më shumë se 30 ditë për arsye teknike, financiare dhe të tjera.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk zbaton menjëherë Ligjin, përkatësisht nuk fillon me transmetim të programit televiziv Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pasëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për fillimin e procedurës për heqje të lejes, do të miraton Vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive televizioni IRIS SHPK Shtip, nr.08-902 datë 8.7.2015.

Z. Petrushevski tha të informohet transmetuesi se kanë filluar të kalojnë 15 ditët shtesë dhe sipas ecurisë së ngjarjeve ashtu dhe Këshilli në pajtim me Ligjin do të veprojë në ditët në vijim.

**Pika 3**

**Të ndryshme**

**Nr. 02-2911/3**

**01.08.2023**

**Shkup**

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**